

VENDIM
Nr. 229, datë 17.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 710, DATË 12.10.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR KËRKESAT DHE
KRITERET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË OPERATORIT TURISTIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 710, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 të vendimit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) emërtimi “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”;

b) emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut” zëvendësohet me fjalët “Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit”.

2. Në shkronjën “dh”, të pikës 4, të nenit 2, të rregullores, që i bashkëlidhet këtij vendimi, fjalët “... pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, dhe rregulloren për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave...” zëvendësohen me “... pranë strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit.”.

3. Neni 3 i rregullores ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

1. Operatori turistik përfaqësohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik, të cilët përveç kriterëve të përcaktuara në shkronjat “b” e “c”, të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik të vërtetojnë se kanë pasur eksperiencë pune në veprimtari të tilla turistike, si: agjenci udhëtimi, strukturë akomoduese, operator turistik, operator turistik detar, udhërrëfyes turistik apo dhe në aktivitete të tjera të lidhura me turizmin;

b) drejtuesi teknik të jetë i punësuar vetëm në një operator turistik, në cilësinë e drejtuesit teknik;

c) drejtuesi teknik, për nevoja të ushtrimit të veprimtarisë së tij, të vërtetojë se zotëron të paktën një gjuhë të huaj nëpërmjet një dëshmie, certifikate, diplome ose një dokumenti të ngjashëm me to, lëshuar nga subjekti i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin për organizimin e testeve ndërkombëtare, në nivelin B2, ose nga institucioni i arsimit të lartë publik apo privat, që është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, për të ofruar programe të akredituara të gjuhëve të huaja, me vlerësim mbi/edhe notën 7 (shtatë).

2. Përfaqësuesi ligjor dhe drejtuesi teknik, në çdo rast, janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.”.

II. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku